



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 770/9 Prot.

Tiranë, më 22.11.2017

V E N D I M
Nr. 159, Datë 22.11.2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË NDËRMARRJEN "TRAJTIMI I
STUDENTËVE NR. 2" SHA TIRANË "MBI ZBATIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO - FINANCIARE"
Për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017

Nga auditimi i ushtruar në Ndërmarrjen "Trajtimi i studentëve nr. 2" SHA Tiranë rezultoi që, ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nuk janë të përhapura dhe nuk janë materiale. Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga drejtori i departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare" të ushtruar në Ndërmarrjen "Trajtimi i studentëve nr. 2 SHA Tiranë", për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.-Gjetje nga auditimi: Në strukturën e shoqërisë ka punësime të pa nevojshëm siç është koordinatori, punën e të cilit mund të kryejë zv/administratori. Në strukturë “Dega e hotelerisë” paraqiten 8 përgjegjës godinash dhe 8 zv/përgjegjës godinash. Në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë, përcaktohet se, zv/përgjegjësi i godinës ka të njëjtat kompetenca, përgjegjësi dhe detyra me përgjegjësin e godinës, me përjashtim të shpërndarjes së bazës materiale, pra kemi të bëjmë me një dublim të pa nevojshëm të detyrave dhe përgjegjësi. Në Degën e hotelerisë ka të punësuar 7 punonjës dushesh, ndërkohë që në degën teknike ka të punësuar 33 punonjës shërbimesh të profesioneve të ndryshme si marangoz, hidraulik, elektrikist, murator, zhbllokues, bojaxhi, specialist tension i lartë, kaldajist, saldator, elektromekanik, punëtor ngarkim shkarkimi (20 sektori i ndërtimit dhe 13 sektori mjekësi). Në strukturën e shoqërisë “Dega teknike” krahas sa më sipër, ka të punësuar 5 elektrikistë, 3 të tensionit të ulët dhe 2 të tensionit të lartë, një numër punonjësish plotësisht i pa arsyeshëm. Janë të punësuar 8 punonjës gjelbërimi, ndërkohë që sipërfaqja e gjelbëruar në dispozicion të godinave në administrim të shoqërisë është shumë e kufizuar.

Janë punësuar punonjës me arsimin profesional të papërshtatshëm për pozicionin e punës që mbajnë, duke cituar si raste, pozicioni punonjës socialë me profesion mësuesinë, pozicioni specialistë planifikimi me profesion jurist, 2 pozicione specialist marketingu me profesion shkenca politike dhe pikturë dizajn, 2 pozicione përgjegjës kulture me profesion ekonomist dhe teknologji ushqimore, etj. Pavarësisht se emërimi i këtyre punonjësve është realizuar në vite, nga ana e drejtuesve të shoqërisë duhet të bëhej punë më e mirë për emërimin e punonjësve sipas sektorëve duke i përshtatur me pozicionin e punës që kanë, si dhe rekrutimin e punonjësve të ri sipas kërkesave të vendit të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 21-24 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Drejtoria e Shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për rishikimin e strukturës organizative, për përshtatjen e vendeve të punës sipas profesioneve, si dhe duke shmangur dublimet e detyrave të punonjësve dhe punësimet e panevojshme.

Brenda vitit 2017

2.-Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të vitit ushtrimor shoqëria ka pasur detyrime të papaguara ndaj të tretëve dhe po kështu në mbyllje të periudhës ushtrimore, ajo ka pasur gjendje në vlera monetare prej 58,227,927 lekë për vitin 2015 dhe 56,211,783 lekë për vitin 2016, të cilat janë mbajtur të bllokuara dhe nuk janë shfrytëzuar për likuidimin e detyrimeve të saj, kjo edhe për faktin se në shumë raste nuk janë kërkuar nga kontraktorët. Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e gjendjes debitore përbëhet nga detyrime të mbartura vite më parë, të cilat u janë mbajtur kontraktorëve në formën e garancisë prej 5% të vlerës, pasi nga personeli i mëparshëm nuk janë kryer procedurat e marrjes në dorëzim dhe për këtë arsye nuk është bërë kthimi i shumës së garancive.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 25-34 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Shoqëria të marrë në shqyrtim rast pas rasti gjendjet debitore dhe monetare, për të bërë të mundur shlyerjen e detyrimeve, në mënyrë që të shmangen penalizimet e mundshme në formën e kamatëvonesave në vijim.

Brenda vitit 2017

3.-Gjetje nga auditimi: Deri në periudhën shtator 2017, nuk ka përfunduar procesi i plotë i inventarizimit të aktiveve të shoqërisë për vitin 2016, pasi Këshilli Mbikëqyrës nuk është mbledhur për vlerësimet dhe miratimet e nevojshme të mallrave të vlerësuara si jashtë

përdorimit. Në përfundim të procesit të inventarizimit për vitin 2015, shoqëria nuk ka marrë masa për shitjen për skrap për materialet të vlerësuara si të tilla në vlerën kontabël 2,609,103 lekë. Në procesin e inventarizimit gjatë vitit pasardhës, këto mjete rezultojnë përsëri në inventarët e shoqërisë, duke bërë edhe veprime në llogaritë kontabël.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 25-34 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- *Administratori i Shoqërisë të marrë masa për përfundimin e procedurave të plota të inventarizimit, atë të zhvillimit të ankandit publik për shitjen për skrap të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit për vitin 2015 dhe vlerësimin dhe marrjen e një vendimi për materialet që duhet të dalin jashtë përdorimit për vitin 2016. Gjithashtu, të merren masa që në të ardhmen kjo procedurë të mos zgjatet në kohë, duke bërë pjesë të pasqyrave financiare tregues të cilët nuk i shërbejnë më shoqërisë.*

Brenda vitit 2017

4.-Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Trajtimi i studentit nr. 2” paraqet për miratim programet ekonomike në Këshillin Mbikëqyrës në kufijtë maksimal kohor të lejuar, po ashtu i dërgon për miratim dhe mendim në instancat përkatëse, jashtë afateve të përcaktuara. Për pasojë, rezulton se pothuaj deri në mesin e periudhës ushtrimore, shoqëria nuk ka marrë ende miratimin përfundimtar nga Aksionari për transaksionet që duhet të zhvillojë, duke krijuar vështirësi në realizimin e aktiviteteve të shoqërisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 12-20 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- *Shoqëria t’i përmbahet afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse për përpilimin e projekt programeve ekonomike, në mënyrë që të mos cenohen këto afate edhe në vazhdimin e procesit të miratimit të tyre nga organet përkatëse.*

Në vazhdimësi

5.-Gjetje nga auditimi: Në projekt programet ekonomike që Shoqëria harton, për periudhën objekt auditimi, rezulton se të ardhurat nga aktiviteti ekonomik i saj paraqiten jo të sakta sa i takon numrit të studentëve të akomoduar, konkretisht të akomoduar me kohë të plotë dhe sezonalë. Po kështu, vihet re se ka probleme në arkëtimin e shumave të plota të detyrimit të studentëve, të cilët aplikojnë shlyerjen me këste, por largohen para përfundimit të vitit akademik pa shlyer të gjithë detyrimin për kohën e akomodimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 12-20 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- *Shoqëria të hartojë një program me tregues ekonomik sa më të studiuar, duke ndarë në mënyrë të detajuar të ardhurat nga studentët e akomoduar në bazë vjetore dhe sezonale, për përcaktuar në mënyrë të saktë numrin e punonjësve të shoqërisë, mbi bazën e raportit 1 punonjës për 12 studentë.
Gjithashtu, nga shoqëria të merren masa që në rast të vazhdimin të praktikës së pagesave me këste, të përcaktohen kushte në kontratat me studentët për shlyerjen e kësteve brenda 6 mujorit të parë të vitit akademik.*

Në fazën e hartimit të projekt programit ekonomik

6.-Gjetje nga auditimi: Lidhur me transaksionet e kryera për blerjet me vlerë të vogël, në asnjë rast nga titullari nuk janë marrë masa për të përcaktuar një person përgjegjës për zbatimin e kontratave dhe në mungesë të këtyre të fundit, për firmosjen e faturës tatimore të

mallrave ose shërbimeve, duke qenë se vlen si e tillë. Në këto raste, rezulton se faturat e dorëzuara janë firmosur herë nga magazinieri, herë nga shefi i financës, apo nga persona të tjerë të cilët mund të kenë qenë të pranishëm.

Kryesisht për shpenzime të kryera për shërbime riparimi, mirëmbajtje apo blerje pajisjesh këmbimi, nuk janë ngritur grupet e marrjes në dorëzim apo të verifikimit të ndërhyrjeve.

Pothuajse në asnjë rast, njësia e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, nuk parashikon kriteret kualifikuese për operatorët ekonomik, pasi në kundërshtim me përcaktimet ligjore nuk kërkon asnjë dokumentacion që vërteton kapacitetin teknik, ekonomik dhe financiar të operatorëve pjesëmarrës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 64-66 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi: Administrator i Shoqërisë të marrë masa për ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim apo verifikimit të ndërhyrjeve të formave të ndryshme, për çdo rast prokurimesh apo shpenzimesh që kryhen nga shoqëria, jo vetëm për procedurat e blerjeve me vlera të mëdha. Po kështu, për çdo rast blerjesh, të përcaktohet personi që do të ndjekë zbatimin e kontratës, ose në mungesë të tij, punonjësi që do të pranojë dhe verifikojë përmbushjen e detyrimeve që lindin nga fatura e dorëzuar. Gjithashtu, nga njësia e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, të merren masa që në çdo rast të hartohen kriteret kualifikuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedura prokurimesh, në mënyrë që të garantohet cilësia e mallrave/shërbimeve të marra dhe përmbushja e detyrimeve të operatorit ekonomik fitues, sipas kërkesave të ndërmarrjes.

Në vazhdimësi

7.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer nga 31 masa të rekomanduara, janë marrë në konsideratë dhe realizuar plotësisht 21 masa, 6 masa janë realizuar pjesërisht apo janë në proces dhe 4 masa nuk janë realizuar, kërkesa të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 8-10 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi: Shoqëria Trajtimi i Studentëve nr. 2, Tiranë, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Brenda vitit 2017

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Trajtimi i Studentëve nr. 2 SHA, të kontabilizojë dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **1,643,506 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1-Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Solar për vitin 2016” rezulton që, pas shqyrtimit të dokumentacionit është skualifikuar operatori ekonomik “R.....” Sh.p.k, për pasaktësi në dokumentacion dhe konkretisht cilësohet “Raporti i analizave të solarit është i datës 14.10.2013, jashtë afatit të përdorimit”. Nga verifikimi i dokumentacionit në rrugë elektronike rezulton se analizat e paraqitura nga operatori ekonomik mbajnë datën 02.10.2014 dhe jo datën 14.10.2013 siç është përshkruar në raportin e vlerësimit të ofertave. Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit nuk rezulton ndonjë kriter i cili përcakton periudhën në të cilën duhej bërë ky raport analizë. Raport analiza e paraqitur

nga ky operator teknik është për sasinë 200 ton, me emërtimin solar dhe që plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Skualifikimi i këtij operatori është bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45.

Nga verifikimi në sistem në lidhje me raport analizën e paraqitur nga operatori ekonomik “T...” Sh.p.k, shpallur fitues, rezulton se raport analiza mban datën 06.02.2016 dhe jo për lëndë djegëse solar, por mazut. Gjithashtu, parametrat e lëndës djegëse nuk janë në përputhje me specifikimet teknike. Lënda djegëse e paraqitur në ofertë nga operatori ekonomik fitues, nuk është e njëjtë me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe nuk plotëson asnjë kriter të përcaktuar, po ashtu lënda djegëse e ofruar nga operatori ekonomik i skualifikuar plotëson kriteret e vendosura. Duke marrë në konsideratë se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar blerjen e një sasive solari rreth 70000 litra, operatori ekonomik fitues ka paraqitur analizë vetëm për 500, litra, ndërkohë që operatori ekonomik i skualifikuar ka paraqitur analiza për sasinë 200000 litra.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45 dhe neni 46.

Si pasojë e skualifikimit të njërit operator i cili ka plotësuar kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe ka paraqitur çmimin më të ulët dhe kualifikimit të operatorit tjetër, **është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,151,566 lekë**, vlerë e cila përfaqëson diferencën e çmimit të ofertave përkatëse, për sasinë e furnizuar të lëndës djegëse në masën 51383 litra. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,151,566 lekë**.

Menjëherë

2. - Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës “Blerje materiale hotelerie për vitin 2016”, rezultoi që materialet janë dorëzuar përtej afatit të përcaktuar në kontratë. Në nenin 10, pika 10.3 përcaktohet: “Shitësi para nisjes së mallrave është i detyruar të njoftojë blerësin përpara se të dërgojë mallin, në mënyrë që komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të marrë masa për pritjen e mallit”. Nga auditimi nuk rezulton të jetë bërë një njoftim i tillë. Nga auditimi rezulton se nga Titullari i AK është lëshuar urdhri nr. 504, datë 19.12.2016 “Për magazinimin e bazës së butë dhe të fortë të hotelerisë”, drejtuar Degës së Financës, Degës së Hotelerisë dhe Sektorit Juridik. Në pikën 1 të këtij urdhri përcaktohet: “Kjo bazë materiale nga të dy operatorët (e fortë, e butë) **do vijë pranë shoqërisë dhe pasi të bëhet kolaudimi nga komisionet përkatëse të dërgohet për magazinim pranë këtij ambienti**”. Sa më sipër rezulton se deri me datë 19.12.2016, nuk është kryer kolaudimi i bazës së butë dhe dokumentacioni i mbartur nga komisioni përkatës nuk është i saktë. Bazuar në sa më sipër, si dhe në dokumentin e hyrjes në magazinë të datës 27.12.2016, rezulton se materialet janë dorëzuar 12 ditë me vonesë.

Bazuar në nenin 13 të kontratës, për dorëzim të vonuar për 12 ditë, kontraktori “A...”, duhet të penalizohet me vlerë 264,960 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 264,960 lekë**, si penalitet i pambajtur Kontraktorit “A...”, për dorëzim të vonuar të materialeve, në kundërshtim me përcaktimet kontraktore.

Menjëherë

3.- Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i materialeve të furnizuara sipas kontratës “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimi për vitin 2016”, rezulton se janë furnizuar 4 pompa furnizimi me ujë, 2 nga të cilat ishin bërë dalje godinave të mjekësisë, por që kanë specifikime të njëjta me pompat gjendje në magazinë. Pompat e furnizuara nuk janë të markës “PEDROLLO” siç përcaktohet në dokumentet e tenderit (pavarësisht se vendosja e markave, është në kundërshtim me ligjin) por “PENTAX”, në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike. Këto pompa nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, duke mos e kryer funksionin për të cilin janë blerë si sa i përket sasisë së ujit të nevojshëm për furnizim, ashtu edhe sa i përket lartësisë së ngritjes. **Vlera 110,400 lekë (4 copë x 23,000 lekë/copë + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A...” Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 110,400 lekë, nga Kontraktori “A...”**, për produkte të furnizuara pa plotësuar kërkesat e dokumenteve të tenderit në lidhje me markën e kërkuar, si dhe për mosplotësim të specifikimeve teknike të kërkuara.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës së furnizimit “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimore, për vitin 2015” ka rezultuar se 2 pompa furnizimi me ujë nuk plotësojnë specifikimet teknike të parashikuara në kontratë. Rezulton se këto pompa nuk plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor si përsa i përket sasisë së ujit që duhet të furnizojë ashtu dhe sa i përket lartësisë së ngritjes së ujit. Pompat janë likuiduar me çmim 45,000 lekë për copë. Ky veprim është në kundërshtim me kontratën e furnizimit neni 5. **Vlera 108,000 lekë (2 copë x 45,000 lekë/copë + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “M...” dhe përbën dëm ekonomik.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 108,000 lekë, nga Kontraktori “M...”**, për produkte të furnizuara pa plotësuar kërkesat e dokumenteve të tenderit në lidhje me markën e kërkuar, si dhe për mosplotësim të specifikimeve teknike të kërkuara.

Menjëherë

5.- Gjetje nga auditimi: Objekti me sipërfaqe 14,3m² pranë godinës 2 Mjekësi është dhënë me qira për një periudhë 1 vjeçare. Qiramarrësi duhet ti paguajë qiradhënësit subjektit N.... B.... detyrimin mujor me vlerën 14.3 m² x **200 lekë/metër** = 2,860 lekë, sipas kontratës nr. 92 datë 17.04.2015. Me shkresën nr 46/1 datë 02.04.2015.

Është dhënë ambient me qira ambienti me sipërfaqe 14,3m² me tarifë mujore **200 lekë** për metër në muaj. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore“. **Tabela A “Tarifat dysheme te qirasë mujore për ndërtesat sipas prefekturave”**, ku për Tiranën, brenda Bashkisë Tiranë tarifa dysheme është e përcaktuar jo më pak se 300 lekë/ m².

Vlera e detyrimit mujor për periudhën 6 vjeçare ka qenë 200 lekë/m². Kjo bie në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 529 datë 08.06.2011 kreun III “ Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë

*shitetore që jepen me qira ose enftiozë” pika c) Për objekt të lirë, tarifa dysHEME e qirasë mujore Bashkia Tiranë është 300 (njëqind) lekë/m². Kjo përbën dëm ekonomik në vlerën: 300-200= 100 lekë/m² x 14,3m² x 6 muaj = 8,580 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 70-71 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 8,580 lekë**, nga subjekti N... B..., përfituar padrejtësisht si pasojë e mos aplikimit të tarifës së qirasë konformë akteve ligjore.

Menjëherë

B.2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.- Gjetje nga auditimi: - Për periudhën janar 2015 deri dhjetor 2015, për largime nga puna pa shkaqe të përligjura, nga ana e Shoqërisë është **likuiduar vlera 22,560,282 lekë**. Kjo vlerë përfshin dëmshpërblim page me vlerë 20,164,467 lekë, shpenzime gjyqësore me vlerë 972,000 lekë, tarifa përmbarimore me vlerë 1,323,978 lekë dhe shpenzime përmbarimore me vlerë 99,458 lekë.

Për periudhën janar 2016 deri dhjetor 2016, për largime nga puna pa shkaqe të përligjura, nga ana e Shoqërisë është **likuiduar vlera 8,408,889 lekë**. Kjo vlerë përfshin dëmshpërblim page me vlerë 7,353,160 lekë, shpenzime gjyqësore me vlerë 611,507 lekë, tarifa përmbarimore me vlerë 374,021 lekë dhe shpenzime përmbarimore me vlerë 70,200 lekë.

Rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, punonjësit e larguar nga puna të cilët kanë fituar dëmshpërblim nga gjykata, kanë aplikuar direkt tek përmbarimi dhe nuk kanë kërkuar zbatimin e vullnetshëm të shoqërisë në likuidimin e pagesave, duke i kushtuar më shumë shoqërisë kosto përmbarimore me vlerë 169,658 lekë.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar, neni 146, pika 3, ku përcaktohet: “Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.

Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, si pasojë e largimeve të punonjësve nga puna pa shkaqe të përligjura, Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve 2” i është shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 30,969,171 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-20 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- Shoqëria Studentët nr. 2 SHA Tiranë, të analizojë largimet e paligjshme nga puna dhe të marrë masa për ristrukturime të argumentuara, për shmangien e pasojave financiare sa i përket shoqërisë dhe sociale sa i përket punonjësve që largohen padrejtësisht nga puna dhe punësimet e panevojshme.

Brenda vitit 2017

2.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, nuk është përllogaritur dhe parashikuar saktë vlera e subvencionit të nevojshëm për funksionimin e shoqërisë, pasi ajo përllogaritet bazuar vetëm në mbulimin e zërit shpenzime page, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003 mbi “Kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit

*buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve”, ku përcaktohet se subvencioni llogaritet si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara të shoqërisë, duke parashikuar dhe një rentabilitet në masën 10%. Për pasojë, vlera totale **22,929,848 lekë**, e cila përfaqëson shumën totale të subvencionit të akorduar më tepër se sa parashikon udhëzimi i mësipërm **konsiderohet efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit**.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 25-34 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi:- *Shoqëria t’i përmbahet formulave të përcaktuara në udhëzimin përkatës për përllogaritjen e saktë të vlerës së nevojshme të subvencionit për aktivitetin e saj, duke përfshirë në llogaritje vetëm zërat që parashikohen në udhëzim.*

Në fazën e hartimit të projekt programit ekonomik

3. - Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje solar për vitin 2015”, nga ana e KVO është skualifikuar nga gara OE me ofertë më të ulët, me argumentimin se nuk ka paraqitur vërtetim likuidim tarifa vendore për të gjitha njësitë ku ushtron aktivitet, pa i kërkuar sqarime. OE duhet t’i jepej mundësia të sqaronte rrethanat, sidomos për faktin se në dokumentet e tenderit nuk është cilësuar nëse kërkohej dokumentacion për të gjithë zonat ku OE ushtron aktivitet dhe nëse i ka të likuiduara detyrimet. Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar **efekt negativ financiar me vlerë 712,146 lekë**. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontrata e mallrave”, Pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

4.-Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale hotelerie për vitin 2016”, është skualifikuar një OE me pretendimin që mostrat e paraqitura nuk janë konformë specifikimeve teknike. Sa më sipër, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 66, pika 3 ku përcaktohet: “...Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal”, KVO duhet të kërkonte sqarime nga OE dhe jo të merrte vendim për skualifikimin e tij nga gara”.

Skualifikimi këtij operatori ekonomik është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 6.a, ku përcaktohet: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike...”. Edhe në Vendimin e KPP nr. 902/2016 prot., datë 24.11.2006 në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “M...” (për këtë procedurë lot I) përcaktohet ndër të tjera se: “Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një OE ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga AK”. KPP, sipas vendimit të mësipërm, sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë, pra nuk përbënte kushte për skualifikim. Vendimi i KPP, ka dalë pas skualifikimit në garën e parë, pra në tenderin e përsëritur dhe KVO. Referuar kontratës së nënshkruar për lot II, me vlerë 4,600,000 lekë, si pasojë e veprimeve të mësipërme **AK i është shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 710,400 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 35-63 të Raportit të Auditimit).

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës neni 12, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

I. “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” për:

1. znj. Xh. Sh,

2. znj. E. E, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje solar për vitin 2016” kanë skualifikuar një OE, për pasaktësi në dokumentacion ndërkohë që nuk është përcaktuar asnjë kriter mbi dokumentacionin e prezantuar me mangësi. Nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton se është kualifikuar një OE tjetër, megjithëse ka mangësi të theksuara në dokumentacion. OE i kualifikuar ka paraqitur raport analizë për një produkt tjetër nga ai i kërkuar në dokumentet e tenderit. Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,151,566 lekë.

-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje solar për vitin 2015”, është skualifikuar nga gara OE me ofertë më të ulët, me argumentimin se nuk ka paraqitur vërtetim likuidim tarifa vendore për të gjitha njësit ku ushtron aktivitet, pa i kërkuar sqarime, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 712,146 lekë.

Znj. E. E, ka qenë anëtare edhe në përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimore, për vitin 2015”, është bërë duke marrë oferta nga subjekte të cilët nuk kanë në objektin e aktivitetit tregtimin e materialeve hidraulike dhe ndërtimore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 59.

Znj. Xh. Sh ka qenë anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim gjatë zbatimit të kontratës “Blerje materiale elektrike, hidraulike, për vitin 2015. Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar produkte të cilat nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 108,000 lekë.

3. z. A. M,

4. znj. H. K,

5. znj. D. K, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale hotelerie për vitin 2016”, është skualifikuar nga gara një operator ekonomik, me argumentimin se mostrat e sjella nuk plotësojnë të gjitha specifikimet e kërkuara, ndërkohë që kërkesat minimale plotësohen, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 6.a, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 53, pika 4, duke **shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 710,400 lekë.**

Znj. H. K, ka qenë anëtare e KOV, në procedurën e prokurimit “Blerje detergjente për vitin 2016, ku KVO ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse oferta e paraqitur ka rezultuar me mangësi, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, pika 4, Par. 1. Po ashtu, gjatë zbatimit të kontratës “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimi për vitin 2016”, grupi i marrjes në dorëzim të materialeve ku edhe znj. H. K, ka qenë anëtare e grupit të marrjes në dorëzim, ka pranuar materiale të cilat nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike parashikuar në dokumentet e tenderit dhe kontratë furnizimi, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 110,400 lekë.

II. “Vërejtje me shkrim” për:

1. znj. M. Gj,

2. z. G. S, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje detergjente për vitin 2016, KVO ka kualifikuar një operator ekonomik edhe pse oferta e paraqitur ka rezultuar me mangësi, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, pika 4, Par. 1.

z. G S ka qenë edhe anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve gjatë zbatimit të kontratës “Blerje materiale hotelerie për vitin 2016”. Furnitori nuk ka bërë lajmërimet paraprake për dorëzimin e materialeve, në kundërshtim me kontratën e furnizimit Neni 10, pika 10.3. Materialet janë dorëzuar me vonesë, vërtetuar nga dokumentacioni i mbajtur për këtë qëllim. Bazuar në kontratën e nënshkruar mes palëve, kontraktori duhet të penalizohej për dorëzim të vonuar me vlerë 264,960 lekë.

3. z. R. S,

4. znj. E. Gj, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për arsye se:

-Përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimore, për vitin 2015”, është bërë duke marrë oferta nga subjekte të cilët nuk kanë në objektin e aktivitetit tregtimin e materialeve hidraulike dhe ndërmore, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 59.

5. znj. A. Gj,

6. znj. A. E, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje detergjente për vitin 2015”, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i është referuar vetëm studimit të tregut, dhe jo alternativave të tjera, pa dokumentuar arsyen e përzgjedhjes së kësaj alternative, si dhe duke marrë oferta nga subjekte të cilët nuk janë regjistruar për gamën e materialeve që kërkohen, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

7. z. B. H,

8. znj. E. Sh, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, për arsye se:

- Në dokumentet e tenderit “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimore, për vitin 2015”, dhe “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimi për vitin 2016”, janë përcaktuar marka për disa produkte si: Pompa uji., Automat 10A Siemens Gjerman, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 23, pika 5.

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje detergjente për vitin 2015”, Njësia e Prokurimit ka vendosur kriteret të pa nevojshme të cilat ulin konkurrencën, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46, pika 3.

13. znj. K. M,

14. znj. R. L, me detyrë specialiste kulture, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim, për arsye se:

Gjatë zbatimit të kontratës “Blerje materiale hotelerie për vitin 2016”, furnitori nuk ka bërë lajmërimet paraprake për dorëzimin e materialeve, në kundërshtim me kontratën e furnizimit Neni 10, pika 10.3. Materialet janë dorëzuar me vonesë, vërtetuar nga dokumentacioni i mbajtur për këtë qëllim. Bazuar në kontratën e nënshkruar mes palëve, kontraktori duhet të penalizohej për dorëzim të vonuar me vlerë 264,960 lekë.

III. “Tërheqje vëmendje” për:

1. z. E. V,

2. z. B. I,

3. z. F. K, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, për arsye se:

Gjatë zbatimit të kontratës “Blerje materiale elektrike, hidraulike, për vitin 2015, komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar produkte të cilat nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 108,000 lekë.

z. B. I dhe z. F. K, kanë qenë anëtar të komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve edhe gjatë zbatimit të kontratës “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimi për vitin 2016”, ku grupi i marrjes në dorëzim të materialeve ka pranuar materiale të cilat nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike parashikuar në dokumentet e tenderit dhe kontratë furnizimi, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 110,400 lekë.

4. z. I. F (përgjegjës i degës teknike),

5. z. R. K, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, për arsye se:

Gjatë zbatimit të kontratës “Blerje material elektrike, hidraulike dhe ndërtimi për vitin 2016”, grupi i marrjes në dorëzim të materialeve ka pranuar materiale të cilat nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike parashikuar në dokumentet e tenderit dhe kontratë furnizimi, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 110,400 lekë.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore si më poshtë:

“Largim nga detyra”, për z. N. N, në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të Trajtimi i Studentëve nr. 2 SHA, Tiranë.

“Vërejtje me shkrim” deri “Pushim nga puna” për:

1. znj. M. T, në cilësinë e Ish-Shefe e Degës së Burimeve Njerëzore.

2. z. M. X, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Meqenëse personat e mësipërm janë larguar nga puna, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R